



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr.10, datë 03.03.2023

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME
FIER SH.A.**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 03.03.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a.",

Konstaton se:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a me shkresën nr.680 prot. datë 10.02.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për licencim.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" (**VKM nr. 302**).
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a me (NUIS M23315402G) është themeluar më datë 08.09.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51% dhe Bashkitë Fier me 33.99 %, Patos me 5.21 %, Roskovec me 4.31 % dhe Mallakastër me 5.49 %;
 - b) Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 225 721 banorë të Bashkive Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër;
 - c) Drejtues teknik i shoqërisë z. Artur Baxhia është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë së Minierave në vitin 1995 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;
5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë Rajonale UK Fier rekomandon:
- a) Shoqëria Rajonale UK Fier, duhet të pajiset me akt miratimet higjieno - sanitare të rinovuara/azhornuara për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë Rajonale UK Fier.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a me (NUIS M23315402G), në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura;
2. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues Ligjor – z. Petrit Kanani
 - b) Drejtues Teknik – z. Artur Baxhia
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a janë Bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër.
 4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2 vjeçare.
 5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
 6. Ngarkohet Drejtoria Teknike Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a për marrjen e këtij vendimi.
 7. Vendimi i KKRR nr.120, datë 20.10.2020 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.429, datë 11.11.2021 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Roskovec sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.37, datë 11.07.2019 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Mallakastër sh.a.”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani